

Prof. dr. Haki KASUMI

## INTERNIMI I FAMILJEVE TË KAÇAKËVE

**V**eprimet e shumta kriminale të pushtetit okupues serb në Kosovë ndaj shqiptarëve bëheshin në përputhje të plotë me planet dhe projektet e hartuara qysh më heret në Beograd e gjetiu. Format dhe mënyra e zbatimit të tyre në esencë nuk dallonin shumë edhe pse kryheshin nga individë e formacione të ndryshme serbe. Të gjitha ato veprime kishin një qëllim të përbashkët dhe vetëm një emërues: " Të likuidohen dhe të çrrënjosen në përmasa sa më të mëdha familjet e njohura shqiptare nga viset e pushtuara pa zgjedhur mjete". Kësaj devize iu përmbajtën me përpikmëri formacionet ushtarake serbe që në ditët e para të depërtimeve të tyre pushtuese në viset shqiptare. Ata vranë, burgosën dhe morën peng shumë shqiptarë në cilësinë e robërve të luftës edhe pse pjesa dërrmuese e tyre fare nuk ishin organizuar për të bërë ndonjë rezistencë.

Interesimi i formacioneve të ndryshme çetniko-ushtarake serbe, që në ditët e para të depërtimit në Kosovë më 1912, nuk ishte i përqendruar vetëm në pushtim, vrasje, plaçkitje e djegie, por njësite të veçanta të tyre bënë hulumtimin e terrenit dhe marrjen peng të

shqiptarëve të pasur trimë. Kapja si rob luftë, gjeçësish marrja peng e njerëzve, ishte bërë dukuri e përditshme në të gjitha viset shqiptare ku kishte depërtuar ushtria pushtuese serbo-malazeze që në tetorin e vitit 1912. Një pjesë e të zënëve rob, përkatësisht e të marrurve peng, menjëherë dërgohej në burgjet serbomalazeze si në: Nish, Leskoc, Pozharevc, Zrenjanin, Beograd, Cetinë, Podgoricë e Kolashin. Në të njëjtën kohë u improvizuan dhe formuan burgje dhe kampe nëpër gjithë Kosovën. Këta njerëz konsideroheshin të rëndësishëm dhe të rrezikshëm, prandaj edhe u bëhej trajtim i veçantë. Të tillë konsideroheshin grupi i Hasan Prishtinës, Idriz Seferit e të tjerë.

Kur brenda një kohe të shkurtër u mbushën burgjet e shumta serbo-malazeze me shqiptarë të pafajshëm dhe nuk mbeti më hapësirë për të tjerë, organet e burgjeve lusin për mosdërgim të njerëzve të tjerë ngase nuk dinin si të vepronin me ta. Në një situatë të tillë pushtetarët serbë gjejnë zgjidhje, bëjnë improvizimin e kampeve të përqendrimit anembanë viseve të pushtuara shqiptare si në: Bihor, Dević, Runik, Mitrovicë, Gazimestan, Prizren, Preshevë, Ferizaj, Shkup, Tetovë e Gostivar.<sup>1</sup> Të gjitha ato kampe u mbushën me qindra e mijëra njerëz të pafajshëm të cilët ishin marrë e mbaheshin të ngujuar nën qiellin e hapur pa asnjë shkas dhe në kushte që nuk do t'u përballonin as kafshët, pa bukë e ujë dhe nën kërcënim të përhershëm të armëve të cilat po ashtu i përdornin pa ndonjë shkas, edhe pse shumica e pengjeve vdisnin nga trajtimi i përgjithshëm. Marrja peng e shqiptarëve nga pushteti okupues i Serbisë kishte filluar në përmasa

---

1. Dr. Hakif Bajrami, Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912, Prishtinë, 2003, fq. 205

të mëdha sidomos në viset e Llapit. Gjatë viteve të para të depërtimit të njësiteve ushtarake serbe nëpër fshatrat shqiptare që kishin pozitë të mirë strategjike stacionoheshin pjesë të njësiteve ushtarake serbe dhe improvizonin llogore dhe kampe përqendrimi ku mbaheshin meshkujt banorë të atyre viseve. Kështu u veprua edhe në Dumosh dhe Shakovicë ku mbaheshin mbi 200 persona më 1914,<sup>2</sup> e të cilët ishin banorë të fshatrave jugore të trevës së Llapit. Në burgun-llogor të Shakovicës qëndroi Met Deshishku më 1914,<sup>3</sup> dhe është individ i rrallë që mbijetoi mizoritë e tmerrshme të krimeve serbe të asaj kohe.

Gjendja nuk ndryshoi shumë as në vitët vijuese kur bëheshin përpjekje për të vendosur pushtetin e mbështetur në ligje e rregullore të veçanta, të cilat dallonin prej atyre që ishin në fuqi në territorin e Mbretërisë së Serbisë.

Një pjesë e udhëheqësve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të viseve që mbetën jashtë kufijve të shtetit të cinguar shqiptar, i cili fitoi pavarësinë në nëntor të vitit 1912, konsolidoi radhët e veta dhe filloi luftën e organizuar për çlirim dhe bashkim nga zgjedha e re sllave. Pushtuesit e rinj të viseve shqiptare që në fillim treguan vrazhdësi më të madhe se paraardhësit e tyre osmanë. Lëvizja e armatosur çlirimtare e lindur dhe e njohur që në kohën e sundimit osman si Lëvizja Kaçake, në kushtet dhe rrethanat e robërisë së re sllave filloi të aktualizohet dhe të forcohet. Në mesin e atyre që kishin luftuar dhe krijuar emër si Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Shaqir Smaka e të tjerë,

---

2. Dr. Hakif Bajrami, Familja Deshishku... (dorëshkrim), Prishtinë, 2005, fq. 50

3. Po aty.

paraqitet edhe Azem Bejta, i cili prej vitit 1912 ishte në radhët e luftëtarëve kundër pushtetit okupues serb. Gjatë përpjekjeve të tilla në këtë kohë ai edhe u zu rob luftime.<sup>4</sup> Trajtimin çnjerëzor të "drejtësisë" serbe Azemi e përjetoi në burgjet famëkeqe të Zajçarit dhe të Pozharevcit ku ishte në vuajtje deri në fillim të Luftës së Parë Botërore.

Me të përfunduar të Luftës së Parë Botërore shumica e shqiptarëve të viseve jashtë shtetit amë-Shqipërisë menduan se kishte përfunduar njëherë e përgjithmonë koha e sundimit të huaj. Ata vepronin, por jo në mënyrë të organizuar për çlirimin dhe konstituimin e pushtetit vendor, i cili konsiderohej me të drejtë pjesë e Shqipërisë. Në këtë frymë veproi edhe Azem Bejta me njësitin e tij pas luftimeve të shumta dhe çlirimit të Pejës me rrethinë nga austriakët dhe "gjithkund vendosi flamuj shqiptarë"<sup>5</sup>. Ngjashëm vepruan edhe një pjesë e prijësve shqiptarë në Kosovë e Shqipëri, por rrjedhat e përgjithshme politike ishin në kundërshtim me synimet e drejta të shqiptarëve.

Në dhjetor të vitit 1918 u vunë themelet e krijesës artificiale të emërtuar Mbretëria SKS, e cila u bë burg gjigand për popujt joserbë e sidomos për shqiptarët dhe pakicat e tjera kombëtare. Mbretëria SKS ishte një vazhdimësi e Mbretërisë së Serbisë e cila të gjitha synimet hegjemoniste, naziste dhe shoviniste serbe i mori përsipër për t'i realizuar. Riokupimin serb të Kosovës e kundërshtuan me armë patriotë të

4. Gazeta "Politika", Beograd, 17.07.1924, fq. 1; Dr. Liman Rushiti, Lëvizja kaçake në Kosovë, Prishtinë, 1981; Mr. Ibrahim Çitaku, Azem Galica dhe veprimtaria luftarake e çetave të Drenicës, Prishtinë, 1996.

5. Gazeta "Politika", Beograd, 17.07.1924, (sлом gospodara Drenice).

shumtë shqiptarë të rreshtuar në radhët e Lëvizjes së armatosur çlirimtare shqiptare.

Me konsolidimin e pushtetit okupues të Mbretërisë SKS shtoheshin edhe masat e shtypjes dhe të përndjekjes kundër shqiptarëve të cilët nuk pajtoheshin me okupim. Pakënaqësitë e shqiptarëve shtoheshin dita ditës, ato rezultonin në të shumtën e rasteve me bashkëngjitje të shumicës së të rinjve njësiteve dhe çetave të Lëvizjes së armatosur çlirimtare kaçake. Në vitet e para të pasluftës botërore pushteti okupues sllav i provokonte masat shqiptare që të arratisen, por kur numri i tyre u shtua, së bashku me ta u shtua edhe pasiguria për pushtetin dhe për popullatën sllave në Kosovë dhe gjendja ndryshoi. Organet e pushtetit filluan të ndërmerrnin masa për zvogëlim të numrit të shqiptarëve të arratisur në male. Së pari u fillua me shantazhim e kërcnime të tjera, me shpresë se gjendjen do ta venin nën kontroll.

Në vitin 1920, komandanti i armates III serbe harton Memorandum për zgjidhjen e problemit shqiptar.<sup>6</sup> Në pikën IV të memorandumit propozohej kapja dhe internimi i kaçakëve dhe i familjeve të tyre. Internimi, që ishte një formë e marrjes peng apo e shantazhimit të njerëzve gjatë viteve të njëzeta të shekullit të kaluar, aplikohet aty-këtu dhe në pamje të parë dukej se po jepte rezultate.<sup>7</sup> Kështu mendonin edhe njohësit e mirë të shqiptarëve, të bindur se ata janë shumë të lidhur për institucionin e familjes. Duke u mbështetur në këto bindje Këshilli Ministror i Mbretërisë SKS mori vendimin për institucionalizimin e masës së

6. Dr. Liman Rushiti, Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës (1878-1941), Prishtinë; 2004, fq. 138.

7. Po aty.

internimit të familjeve të kaçakëve me dt. 21 janar 1921. Në bazë të këtij vendimi Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një proklamatë me të cilën ftoheshin të gjithë të arratisurit që të dorëzoheshin deri më 10 mars 1921, në të kundërtën "në ato vende ku gjenden çetat do të dërgohet xhandarmëria dhe ushtria, të cilat do t'i përdorin të gjitha masat".<sup>8</sup> Për këtë çështje Këshilli Ministror emëroi komisarin e jashtëzakonshëm shtetëror (Mihajlo Ceroviçin).<sup>9</sup> Në proklamatë shkruhej gjerë e gjatë për operativën e punës së komesariatit dhe për pasojat që do t'i kenë familjet, jatakët dhe të gjithë ata që i strehojnë apo ndihmojnë të arratisurit. Pasoja do të ketë jo vetëm familja, por edhe fshati, e në rast nevojë edhe i tërë rrethi. Ndër masat e tjera që parashiheshin në proklamatë ishin edhe ndjekjet e përmasave të gjera, bastisjet në çdo fshat, përrua, mal. Thuhej se do të bastisen edhe të gjitha shpellat ku mund të strehohen kaçakët. Të gjitha shpenzimet e nevojshme të ushtrisë dhe xhandarmërisë do t'i bartë populli i atij fshati ku sillet apo vepron kaçaku.

Me amnistinë e janarit të vitit 1921 përfshiheshin të gjithë ata të cilët kishin bërë delikte të ndryshme dhe vrasje në kohën e Luftës së Parë Botërore, përfundimisht deri më 16 gusht 1919. Sipas kësaj amnistie vrasësit liroheshin vetëm nga dënimi me vdekje, por jo edhe nga dënimi me burg. Të arratisurit politikë në këtë amnisti nuk përmenden fare.<sup>10</sup>

Momenti i shpalljes së aktit të amnistisë nuk ishte i volitshëm për lëvizjen çlirimtare dhe për popullin

8. Dr. Liman Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë*, Prishtinë 1981, fq. 156.

9. Po aty.

10. Gazeta "Politika", Beograd, dt. 29.01.1921, fq. 3.

shqiptarnë përgjithësi. Në anëntjetër, pushteti okupues serb bënte punët e veta, hartonte dhe plotësonte listat e kaçakëve nëpër rrethe. Të gjithë të shpallurit kaçakë konsideroheshin njerëz kundër shtetit dhe çdo kush mund t'i vriste e të mos konsiderohej përgjegjës. Ministria e Punëve të Brendshme me vendimin nr. 2057 të datës 29 janar 1921, urdhëroi të gjithë naçallnikët e qarqeve që të përpilonin regjistrat e kaçakëve, të cilët ishin të shpallur me vendim gjyqi për të arratisur.<sup>11</sup> Para se të shpallehin, gjyqi me vendim i ftonte që t'u dorëzoheshin organeve shtetërore. Ai që nuk i përgjigjej thirrjes me vendim gjyqi shpallej i arratisur – kaçak dhe konsiderohej njeri kundër ligjit dhe me këtë ai kishte konsekuenca, i bëhej shantazh kokës së tij që vlerësohej në bazë të funksionit, autoritetit në lëvizje për vepra të kryera. Shantazhi për të arratisurit politik bëhej me shuma të mëdha të hollash. Shuma ishte e madhe sidomos për prijësit e çetave dhe sillej prej 500-10.000 dinarë. Të gjithë shqiptarët e arratisur në male ishin shpallur kaçakë të rrezikshëm. Numri i kaçakëve në listat e përpiluara nga zyrtarët e mbretërisë nuk ishte i saktë dhe as i plotë. Sipas studiuesit të Lëvizjes Kaçake dr. Liman Rushiti, numri i kaçakëve në bazë të raporteve zyrtare ishte 868, ndërsa sipas të dhënave të shtypit të Beogradit dhe dokumenteve të tjera serbe, ai sillej prej 2000-2500, por edhe sipas tyre ky numër nuk ishte i plotë.

Sic thamë edhe më lart, internimi i familjeve të kaçakëve kishte filluar që nga nëntori i vitit 1912, kur ishin internuar individë e familje të shumta shqiptare për të cilat qeveria kishte të dhëna se

11. Si shënimi 8, fq. 157.

ishin kundërshtarë të pushtetit. Ndërkaq internimi i përmasave të mëdha u bë në bazë të vendimit të 21 janarit të vitit 1921, mu në ditën e skadimit të afatit të amnistisë më 20 mars 1921. Në fillim të kësaj fushate antishqiptare bëhej grumbullimi i familjeve nëpër burgje të rretheve. Pas mbushtjes së burgjeve me familjarë shqiptarë, grumbullimi i të tjerëve bëhej nëpër shtëpi të braktisura të shqiptarëve të shpërngulur. Këto qendra grumbullimi ruheshin nga rojat e xhandarmërisë apo të ushtrisë serbe derisa dërgoheshin në kampet e përqendrimit të ndërtuara pranë burgut të Nishit e gjetiu në Serbi. Kishte raste kur pritej edhe deri në dorëzimin e të arratisurit – kaçakut.

Do përmendur se pushteti ushtarako-policor i Mbretërisë SKS kishte improvizuar shumë kampe të tilla anembanë viseve të okupuara shqiptare pranë të gjitha burgjeve të rretheve. Vlen të veçohet ai i rrethit të Drenicës në Deviç, i zgjeruar në pranverë të vitit 1921, si dhe ai në Runik. Ai kamp përqëndrimi ishte i rrethuar me tela gjemborë dhe ruhej nga shumë roja xhandarmërie e ushtrie serbe. Aty mbaheshin peng familjet e trimave të maleve shqiptare deri në tre muaj e pastaj dërgoheshin në qendrat e mëdha në kampe përqëndrimi të ndërtuara vetëm për shqiptarë në gjithë territorin e Serbisë.

Me rastin e internimeve të familjeve të kaçakëve pushtetarët kishin urdhëruar pjesëtarët e ekspeditave famëkeqe të xhandarëve serbë që të ishin sa më brutalë ndaj të gjithë atyre që duhej të izoloheheshin pa dallim moshe e gjinie. Në këtë kohë u internuan, përveç të tjerëve, edhe tri familjet Loshi nga Padalishta, në mesin e të cilave ishin edhe tri gra shtatzëna që lindën

tre djem në kampin e përqendrimit në Nish. Në këtë kohë ishin internuar edhe prindërit e moshuar të Sali Shabanit nga Kabashi i Prizrenit, pastaj gruaja e Jetish Behlulit me fëmijë të mitur nga Budakova e shumë të tjerë. Në prill të vitit 1921 u ndërmor një fushatë e tmerrshme e marrjes peng dhe e internimit të shumë familjeve anakënd viseve të pambrojtura etnike shqiptare që nga Skënderaj, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Prishtina, Podujeva, Ferizaj, Shkupi, Tetova, Gostivari, Manastiri, Kërçova, Dibra, Struga e Ohri.

Më 23 mars 1921 u internuan në kampin e Nishit këto familje: nga Qarku i Prishtinës: nëna e vëllezërve Ibush dhe Esad Vuçiternalisë (pasi nuk kishte anëtarë të tjerë të familjes), Bajram Tërnavës- 5 anëtarë (tërë familjen), Latif Bajramit- gruan me djalë dhe të vëllain e gruas, kurse Gjekush Bajraktarit edhe pse ia rrethuan shtëpinë nuk i gjetën njëri të gjallë në të.<sup>12</sup>

Internimet kishin vazhduar edhe në të gjitha viset e tjera të Kosovës. Sipas raportit telegrafik të udhëheqësit kryesor të punëve për internim, komisarit të jashtëzakonshëm për Kosovë Mihajlo Ceroviq, me 10 prill 1921 në kampin e Nishit ishin internuar familje kaçakësh: Nga Qarku i Metohisë (Dukagjinit) 21 familje me 74 anëtarë; nga Qarku i Zveçanit 22 familje me 60 anëtarë; nga Qarku i Kosovës 16 familje me 81 anëtarë; nga Qarku i Prizrenit 11 familje me 44 anëtarë; nga Qarku i Tetovës 12 familje me 58 anëtarë; nga Qarku i Kumanovës 3 familje me 14 anëtarë; nga Qarku i Rashkës (Novi Pazar, Tutin) 13 familje me 69 anëtarë; nga Qarku i Manastirit 6 familje me 20 anëtarë dhe nga Qarku i Ohrit 1 familje me 5 anëtarë.<sup>13</sup>

12. Po aty, fq. 158.

13. Po aty.

Nga të dhënat telegrafike vetëm në një raport të kësaj kohe thuhet se janë internuar 105 familje shqiptare me 425 anëtarë. Ndërkaq në arkivat historike të ish-Jugosllavisë ekzistojnë me qindra e mijëra raporte të tilla, ku ka shumë e shumë të dhëna për familjet e internuara shqiptare, ndërsa në to ka fare pak apo mungojnë tërësisht të dhënat për vuajtjet e shumta të tyre.

Dihet mirëfilli se çdo regjim, e sidomos regjimet e pushteteve okupuese, siç ishte ai serb, përkatësisht jugosllav, që kishin qëndrim dhe trajtim të egër dhe brutal ndaj popullatës shqiptare e cila nuk pajtohej me gjendjen të cilën mendohej t'ia impononte regjimi pushtues serb. Nga vetë qëllimi i padrejtë për izolimin e tyre mund të nxirret një pjesë e përgjigjes për trajtimin dhe vuajtjet e këtyre njerëzve të ndershëm por të pambrojtur. Me pak fjalë, ato ishin përjetime të rënda, të vrazhda, të përcjella me të gjitha të këqijat që mund t'i bëhen një njeriu të pambrojtur e i cili nuk pajtohet me nënshtrimin.

Gjendja e përgjithshme shumë e rëndë pasqyrohet pjesërisht në mllëfin e një kaçaku të shprehur në shtypin e kohës në një konfrontim fjalësh me një zyrtar serb: "Ju jeni qenë, ju jeni fajtorë për vuajtjet e familjeve tona, gjakun tuaj do ta pijmë deri në Millanovc",<sup>14</sup> ku ishte familja e tij së bashku me shumë familje të tjera shqiptare e ngujuar në kampin e përqendrimit.

Ndikimi i ligjit për amnistinë dhe i vendimit të Këshillit Ministror për internimin e familjeve të kaçakëve ishte godije e rëndë për Lëvizjen e armatosur shqiptare të atyre viteve. Vetëm në javën e parë pas skadimit të afatit për amnisti në mars të

14. Gazeta "Politika", Beograd, dt. 18.06.1921, fq. 1.

vitit 1921 dhe pas marrjes peng të familjeve të tyre u dorëzuan 174 kaçakë vetëm nga rrethi i Pejës. Vlen të veçohet rasti i familjes së Kerit të Sadri Bardhit nga Haxhaj i Rugovës. Këtij pushteti jugosllav ia kishte konfiskuar tërë pasurinë, ndërsa më 1921 me urdhrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme i internohet e tërë familja dhe i ngujohet në Kullën e Gllaviqicës afër Pejës. Nga ky presion ky kaçak i njohur detyrohet të dorëzohet për ta shpëtuar familjen, ndërsa më vonë nga presionet e pushtetit okupues detyrohet të ikë në Shqipëri së bashku me tërë familjen.<sup>15</sup>

Vlen të theksohet se prej kaçakëve të dorëzuar 90 % ishin dezertorë ushtarakë, ndërsa nuk përmendet asnjë individ që ishte i njohur si kaçak i kategorisë së luftëtarëve për çlirim e bashkim të trojeve shqiptare.

Shantazhimi dhe lojërat e ndyta të pushtetit okupues me familjet e internuara të një pjese të kaçakëve ishin të shumta dhe të rënda. Ato vazhduan deri më 1925, pra deri atëherë kur pushteti okupues sllav konsideronte se e kishte shpartalluar dhe shtypur lëvizjen e armatosur shqiptare për çlirim e bashkim të viseve të robëruara me shtetin amë – Shqipërinë. Ishte ky një parashikim i bazuar në dëshirat e autoriteteve hegjemoniste serbe që nuk kishte të bënte me gjendjen reale në terren.

---

15. Dr. Liman Rushiti, *Kujtime për Lëvizjen Kaçake*, Prishtinë, 2003, fq. 16.

The text on this page is extremely faint and illegible, appearing as a series of light grey smudges and ghosting of characters. It seems to be a dense block of text, possibly a list or a detailed report, but the individual words and sentences cannot be discerned.